

17.09.2019

S T A T U T I
I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“COFEA EXPRESS” shpk

FORMIMI
NENI 1

5.2 1.1 Formohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar **“COFEA EXPRESS” shpk** e Ortakëve themelues Maria TASHO, lindur në Athinë, më 30.11.1992, me banim në Tiranë Rruga “Medar Shtylla” Pallati 54, Hyrja 4, ap.16 me Nr. pasaporte J26130038I, madhore, dhe Kristi Tasho shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 25.12.1996, me banim në Rrugën “Medar Shtylla”, Ndërtesa 54, Hyrja 4, Apartamenti 16, me pasaportë nr. J66225060Q me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

NENI 2

2.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Medar Shtylla, Pallati 54, Apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryejë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet filialeve, degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjensitë e saj, të cilat janë krijuar me vendim të Ortakëve të Shoqërisë dhe do të veprojnë nën mbikqyrjen e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 3

3.2 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar, për një periudhë kohore të pakufizuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

4.1 Shoqëria mund të kryejë ç’do aktivitet të lejuar nga ligji në Republikën e Shqipërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në:

a) Shpërndarjen e Kafes

4.2 Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të mësipërme, Shoqëria mund të ushtrojë veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë cdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës, të jashtëm, plotësues apo të dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

NENI 5

5.1 Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, seline, kohezagjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrin Ortakët.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

KAPITALI I REGJISTRUAR

5.3 6.1 Kapitali i fillestar i Shoqërisë është “Cofea Exress” sh.p.k do të jetë 200.00 Lekë (dyqind



Lekë) ku secili zotëron nga 1 kuotë 70% për Maria Tasho në vlerën 140.00 lekë, kurse Kristi Tasho zotëron 30% në vlerë 60.00 lekë.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 7 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 7.1 Në përputhje me nenin 81, pika 3, e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", Ortakët ushtrojnë të gjitha të drejtat dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Në mënyrë të veçantë, duhet të regjistrohen vendimet e mëposhtme për:
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - h) vendime për investime;
 - i) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - j) marrjen përsipër të detyrimeve nga Shoqëria për shumat mbi 15.000 Euro për çdo veprim ose nëse tejkalojnë shumën totale 15.000 F.uro në një vit kalendarik.
- 7.2 Çdo vendim i Ortakëve që nuk është regjistruar në regjistrin e vendimeve do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm. Ortakët vendosin për të gjitha çështjet e parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".
- 7.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencë dhe/ose videokonferencë, në përputhje me ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 7.4 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga administratori/ët ose ortakët e Shoqërisë, në përputhje me parashikimet e nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", dhe sa herë që thirrja është e detyrueshme sipas ligjit. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, telefax ose letërporosi, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht në rast se, pavarësisht respektimit të formaliteteve të mësipërme, të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë dakord për rendin e ditës dhe të marrin vendime për «çështjet përkatëse».
- 7.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Kryetari, i zgjedhur ndërmjet të pranishmëve. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
- 7.6 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.



**NENI 8
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 8.2 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm i zgjedhur nga Ortakët për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori i vetëm rizgjidhet ose shkarkohet nga Ortakët. Administratorja e parë e Shoqërisë do të jetë Znj. Maria Tasho, shtetase shqiptare, lindur në Athinë, më 30.11.1992, me banim në Rrugën "Medar Shtylla", Ndërtesa 54, Hyrja 4, Apartamenti 16, me pasaportë nr. J26130038I, e caktuar në detyrë nga data e regjistrimit të kësaj Shoqërie e për 5 vitet pasuese. Organi i administrimit zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre akteve që janë në kompetencën e Ortakëve. Do të miratohen paraprakisht me shkrim nga Ortakët të gjitha veprimet e administratorit të vetëm që sjellin një angazhim/detyrim për Shoqërinë për shumat mbi 30.000 Euro për ç'do veprim ose nëse tejkalojnë shumën totale 30.000 Euro në një vit kalendarik. Administratori mban përgjegjësi për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të delegojë tjetretë për të kryer veprime dhe akte të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në ç'do rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimtarinë e të tretëve që ka autorizuar.

NENI 9

- 9.1 Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut, Akti i Themelimit të saj si dhe normat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Shoqëria fiton zotesinë për të vepruar me njohjen e saj si person juridik nga Qendra Kombëtare e Biznesit Tirane dhe me regjistrimin si subjekt privat në organin përkatës tatimor.

NENI 10

- 10.1 Shoqëria merr përsipër të drejta e detyrime kontraktuese e jashtë kontraktuese brenda kufijve të kapitalit të saj themelor. Ortakët mbartin rrezikun për veprimtarinë ekonomike të shoqërisë brenda kapitalit të shoqërisë dhe nuk përgjigjet për detyrimet që shoqëria ka ndaj të tretëve me pasurinë e tij vetiake.

NENI 11

- 11.1 Ortakët themelues miratojnë programin e shoqërisë, hartojnë raportin e administrimit, inventaret, llogaritë vjetore, të cilat hartohen brenda një afati 6 mujor duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar. Vendos për shpërberjen e shoqërisë. Vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve. Rregullon maredheniet e punësimit e të shpërblimit brenda shoqërisë. Shlyen detyrimet ndaj organeve shtetërore, personave juridike e fizike, vendas a të huaj.

NENI 12

- 12.1 Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë Ortakët emerojnë e punesojnë Administratore të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të vecanta që ligji i jep shprehimisht Ortakëve.

MARREDHENIET E PUNES

NENI 13

- 13.1 Maredheniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çeshtjet që kjo kontratë nuk i përshikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit Shqiptar në fuqi.



SEKRETI I PUNES

NENI 15

- 15.1 Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga kjo shoqëri .

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

NENI 16

- 16.1 Shoqëria përfaqësohet nga Administratorja Znj. Maria Tasho për një afat 5 vjecar, me të drejtë përsëritje.

KONTROLLI I BRËNDSHËM

NENI 17

- 17.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët do të emërojnë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në të gjitha ato raste kur emërimi konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet nga ligji.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 18

BILANCI VJETOR

- 18.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit të administrimit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Ortakët.
- 18.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Ortakët brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 18.3 Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të ç'do viti, përveç rasteve dhe urdhërave të veçanta të Ortakëve të saj.
- 18.4 Në fund të ç'do periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik **humbje, fitime**. Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe mbas pagimit të detyrimeve fiskale. Pjesa që mbetet i jepet për përdorim ortakut të vetëm të saj.

NENI 19

DIVIDENDI

- 19.1 Në përputhje me dispozitat e ligjit, Ortakët vendosin mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

NENI 20

- 20.1 Pasuria e shoqërisë është lirisht e trashëgueshme në rrugë trashëgimie. Fitimi i mbetur kalon në pronesi të Ortakëve themelues mbasi të jenë shlyer te gjitha detyrimet tatimore, detyrimet ndaj të



tretëve si dhe pagesat e mundshme për punonjësit e shoqërisë.

NENI 21
VULA, STEMA

- 21.1 Shoqëria "COFEA EXPRESS" shpk ka vulën mbi të cilën ka të shkruar emërtimin e saj.

NENI 22
LLOGARIA BANKARE E SHOQERISE

- 22.1 Shoqëria në përputhje me legjislacionin financiar ka të drejtë të hape llogarinë e vet bankare në bankat e nivelit të dytë. Në këto llogari shoqëria ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet financiare.

NENI 23
SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

- 23.1 Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në c'do kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast mbyllje, ortakët vendosin mbi mënyrën e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatorë duke i përcaktuar edhe detyrat konkrete. Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi: Shoqëri në likuidim e sipër. Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqëria c'rrregjistrohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit Tiranë.

NENI 24
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 24.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Ortakëve dhe administratorit të Shoqërisë do të jenë fillimisht objekt konsultimi miqësor mes palëve, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga lindja e mosmarrëveshjes apo nga data kur mosmarrëveshja është komunikuar me shkrim nga njëra nga palët.
- 24.2 Në rast se mosmarrëveshja nuk do të zgjidhet miqësisht, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 25
GJUHA

- 25.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet nga Ortakët në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe.

NENI 26
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE


- 26.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe ligjin shqiptar në fuqi. Për sa nuk është parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- 26.2 Statuti përpilohet në katër kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente për rregjistrimin e saj si person juridik dhe si Subjekt Privat.
- 26.3 Një kopje e tij mbetet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të formimit të shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "COFEA EXPRESS" shpk.

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR



COFEA EXPRESS

Marisa Tasho
Emer Mbiemer

Kristi Tasho 
Emer Mbiemer

